FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 13

Tiranë – E martë, 26 janar 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1156, datë 24.12.2020	Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre.....	1907
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 20.1.2021	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021.....	1910
Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 4 , datë 31.12 2020	Mbi kriteret dhe procedurën për certifikimin e operatorëve të turizmit detar.....	1915
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 419, datë 14.12.2020	Për disa ndryshime në urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 169, datë 10.6.2020, "Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor".....	1917
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 23, datë 18.1.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 434, datë 22.7.2020, "Për miratimin e përbërjes së komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, të nivelit të parë dhe epror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara".....	1918
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 30, datë 18.1.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 682, datë 21.12.2020, "Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Britaninë e Madhe", të ndryshuar.....	1918
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 1, datë 11.1.2021	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2020.....	1918
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 2, datë 11.1.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë "Albpetrol" sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s.....	1920
Kërkese e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 638/4, datë 21.1.2021	Për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative 4 dhe 8, zona "5 Maji", Bashkia Tiranë.....	1921

Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 761/3, datë 20.1.2021	Për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në zonën e re për zhvillim, Njësia Administrative nr. 6, zona Kombinat, Bashkia Tiranë.....	1949
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 919, datë 21.1.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Kalimash–Morinë".....	1965
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Levend Fuat Levendaj.....	1968

VENDIM
Nr. 1156, datë 24.12.2020

PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË GJENERUARA NGA TARIFAT QË PAGUHEN NË ZONAT E MBROJTURA, TË MASËS DHE KRITEREVE TË PËRDORIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 58, të ligjit nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifat vjetore janë të ardhurat nga tarifat që paguhen për ushtrimin e veprimtarive ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura, tarifat që paguhen nga transporti në territoret e tyre, si dhe tarifat që paguajnë vizitorët e turistët, të cilët vizitojnë këto zona.

2. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifat vjetore administrohen nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (në vijim AKZM-ja), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

3. Çdo vit AKZM-ja harton:

a) planin e të ardhurave të siguruara nga tarifat vjetore për aktivitetet e përcaktuara në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) planin/et financiar/e të përdorimit të të ardhurave të siguruara nga tarifat.

4. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifat përdoren nga AKZM-ja në masën:

a) 60 % për:

i. investimet në zonat e mbrojtura;

ii. hartimin e planeve të menaxhimit për zonën e mbrojtur mjedisore (në vijim ZMM-ja) dhe inventarizimit të pyjeve, të kullotave, monitorimin e florës dhe të faunës së egër;

iii. projektet e pyllëzimit, për përmirësimet, luftimin nga gërryerjet, shtigjet në zonat e mbrojtura, rehabilitimin e habitateve dhe të peizazhit, largimin e menaxhimin e specieve invazive të huaja;

iv. masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri;

v. ndërtimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës brenda zonave të mbrojtura për komunikimin, pritat malore, gardhimet, për ndërtesat dhe qendrat e vizitorëve (në vijim QV-ja);

vi. publikimet, ndërgjegjësimin, edukimin e informimin e publikut të gjerë;

b) 40 % për:

i. masat për parandalimin dhe luftimin e erozionit;

ii. luftimin e sëmundjeve e të dëmtuesve;

iii. mbarështimin, ushqimin e sigurimin e kushteve të jetesës për faunën e egër;

iv. blerjet e mjeteve të komunikimit e transportit, për mobilimin dhe përmirësimin e kushteve të punës së administratave rajonale të zonave të mbrojtura (në vijim AdZM-ja) dhe punës në terren;

v. përballimin e shpenzimeve për punësime sezonale për aktivitete brenda zonave të mbrojtura;

vi. mbështetjen e aktiviteteve tradicionale të komuniteteve lokale.

5. Tarifat vjetore për aktivitetet dhe shërbimet e ofruara në zonat e mbrojtura janë në përputhje me lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Aplikimi i tarifave hyn në fuqi në 1 shtator 2021.

6. Kriteret bazë për përdorimin e të ardhurave të gjenuara nga tarifat janë:

a) rëndësia e zonës së mbrojtur sipas kategorisë dhe vlerësimit të shkallës së natyralitetit;

b) numri i turistëve që vizitojnë zonën, si shprehje e vlerës së zonës;

c) interesi i komuniteteve lokale në përfitimin e investimeve;

ç) sasia e të ardhurave që arrin të grumbullojë administrata rajonale;

d) tregues të performancës në punë e stafit të administratës rajonale.

7. Planifikimi i investimeve për vitin pasardhës, për të gjitha llojet e aktiviteteve në ZMM, që financohen nga të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, propozohet nga administrata rajonale e zonave të mbrojtura dhe miratohet nga AKZM-ja, duke mbajtur në konsideratë planin financiar, masën e kriteret e përcaktuara sipas këtij vendimi dhe në planet e menaxhimit për secilën zonë.

8. Drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së ngre një grup pune për vlerësimin e propozimit të planit të të ardhurave për AKZM-në brenda muajit dhjetor, duke vlerësuar e përcaktuar projektet që do të zbatohen vitin e ardhshëm, sipas prioriteteve të programit të menaxhimit të ZMM-së dhe kritereve të përcaktuara në pikën 6, të këtij vendimi.

9. Pas miratimit të planit të të ardhurave të gjeneruara nga tarifat, ndarja e përdorimit të të ardhurave të grumbulluara bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, sipas planifikimit dhe projekteve që financohen.

10. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, sipas këtij vendimi, kanalizohen nëpërmjet llogarisë së thesarit dhe përdoren nga AKZM-ja si të ardhura jashtë limitit mbi bazë të legjislacionit në fuqi.

11. Të ardhurat e akumuluara në llogarinë jashtë thesarit në bankën e nivelit të dytë, me emërtimin "Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave", gjatë periudhës kohore nga momenti i krijimit të AKZM-së e deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, do të transferohen në llogarinë e të ardhurave të thesarit dhe do të administrohen nga AKZM-ja, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

LISTA E TARIFAVE PËR ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE

Për veprimtaritë që kryhen brenda zonave të mbrojtura mjedisore, në përputhje me dizpozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura" dhe të akteve të tjera nënligjore në fuqi, paguhet tarifë vjetore, si më poshtë vijon:

1. Tarifa e shërbimit

a) angazhimet dhe shpenzimet administrative të AKZM-së vlerësohen si shërbime ndaj të tretëve dhe paguhen nga kërkuesi në formën e tarifës së shërbimeve;

b) vlera e tarifës përfshin shpenzimet administrative dhe të gjitha veprimtaritë konkrete të stafit të AKZM-së dhe AdZM-së, gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës e të kryerjes së shërbimit;

c) tarifa e shërbimit e paguar është e pakthyeshme, pavarësisht nga fakti nëse kërkesa miratohet ose jo përfundimisht nga ministri përgjegjës apo drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së.

Tarifa e shërbimit për:

a)	dhënien e autorizimeve/lejeve të ndryshme	5 000 lekë/çdo kërkesë;
b)	dhënien e të dhënave statistikore, harta, për florën e faunën e egër, e të tjera të kësaj natyre për ZMM-në	15 000 lekë/çdo kërkesë;
c)	kryerjen e ekspertizës në terren	50 000 lekë/çdo kërkesë.

2. Tarifat e materialit drusor të rezultuara nga kryerja e punimeve të shëndetësimit apo dhe nga faktorët natyrorë

Të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve të ndryshme realizohen vetëm në rast se janë parashikuar në planin e menaxhimit ose vijnë si pasojë e emergjencave natyrore dhe të projektit teknik të miratuar nga AKZM-ja. Materiali drusor i rezultuar i shitet në radhë të parë komunitetit, i cili ndodhet brenda territorit të ZMM-së, me qëllim përballimin e nevojave të tyre për ngrohje, gatim a përdorime të tjera vetjake, si dhe subjekteve private brenda zonës, mbi bazën e tarifave të mëposhtme:

a) për komunitetin:

i. drutë e zjarrit 500 lekë/mst;

ii. asortimentet e lëndës së punimit me koston e prodhimit;

b) për subjektet private, të gjitha asortimentet e prodhuara shiten me koston e prodhimit + fitmin, jo më shumë se 15% të kostos.

Në rastet kur punimet do të kryhen në pronat private, në bazë të miratimit paraprak nga AdZM-ja, pronari ka të drejtë të veprojë në përputhje me interesat e tij për materialin drusor që do të rezultojë.

3. Tarifat për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të ZMM-së

(të miratuara konform dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi)

a) Vlera e sipërfaqes së zënë nga ndërtesa/trualli/biznesi:

Për veprimtari ekonomike në zonat e mbrojtura që lidhen me ndërtime për qëllime pushimi dhe argëtimi (kënde lojrash, mjedise sportive, çlodhëse etj.):

- Sipërfaqja me bimësi pyjore	10 lekë/m²/vit;
- Sipërfaqja me bimësi kullosore	7 lekë/m²/vit;
- Sipërfaqja pa bimësi	4 lekë/m²/vit;
- Sipërfaqja ujore	8 lekë/ m²/vit.

Për trojet me pronësi nuk paguhen tarifa.

b) Vlera e sipërfaqes së oborrit që rrethon ndërtesën/truallin/biznesin:

Për veprimtari ekonomike në zonat e mbrojtura që lidhen me ndërtime për qëllime biznesi, komplekse, hotele, restorante, bare, objekte tregtie, pushimi dhe argëtimi (kënde lojrash, mjedise sportive, çlodhëse etj.)

- Sipërfaqja me bimësi pyjore	6.5 lekë/m²/vit;
- Sipërfaqja me bimësi kullosore	4.5 lekë/m²/vit;
- Sipërfaqja pa bimësi	3 lekë/ m²/vit;
- Sipërfaqja ujore	5 lekë/ m²/vit.

c) Vlera e sipërfaqes për dhënien në përdorim për veprimtari ekonomike:

- Objekte tregtie, bare, restorante, hotele	500 lekë/ m²/vit;
- Qendra ose komplekse pushimi, kurimi dhe turistike	800 lekë/ m²/vit;
- Vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizshme, televizive, të radiokomunikimit	1 000 lekë/ m²/vit;
- Kryerjen e operacioneve shpim-kërkim uji, gazi, nafte, shtrirje tubacionesh në sipërfaqe, ndërtim linje tensioni të lartë, ndërtim kanalesh, hidrokarbure, gjeologjike e minerare, gërmime dhe depozitime materialesh në sipërfaqe, ngritje objektesh të ndryshme	1 000 lekë/m²/vit.

ç) Vlera e sipërfaqes për dhënien në përdorim për aktivitetet si:

- kultivimi i bimëve të ndryshme mjekësore, aromatike dhe eterovajore	3 lekë/m²/vit;
- mbarështrimi i faunës së egër	10 lekë/ m²/vit.

4. Tarifat për qëllime të grumbullimit dhe përdorimit të prodhimeve të ndryshme nga ZMM-ja

Në nënzonat e lejuara, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në planin e menaxhimit

Fashina, shkarpa	mst 30 lekë;
Mbeturina pylli të çdo lloji	m³ 40 lekë;
Thupra të çdo lloji	kv 100 lekë;
Kucka, rrënjë	kv 250 lekë;
Cungje	m³ 300 lekë;
Hunj, bandiera	000/copë 500 lekë;
Bar për blegtorinë	kv 30 lekë;
Gjethe për blegtorinë	kv 60 lekë;
Mbledhja e bimëve mjekësore për qëllime jotregtare	kg 10 lekë;
Mbledhja e bimëve mjekësore për qëllime tregtare	kg 150 lekë;
Fryta, fara e sytha	Kv 800 lekë;
Lëvore	Kv 600 lekë;
Kërpudha të ndryshme	kv 5 000 lekë;
Tartufi	kv 600 000 lekë;
Boçe të ndryshme	kv 450 lekë;
Degë të gjelbëra, me dhe pa lule, për buqeta	kv 200 lekë;
Degë me gjethe për përdorim si fshesa	kv 300 lekë;
Nxjerrje e grumbullim guri, rëre, zhavori, dheu, hunuesi*	m³ 100 lekë.

a) Kullotja me leje dhe ngritja e staneve:

Gjedhët	500 lekë/krerë/vit;
Të leshtat	100 lekë/krerë/vit;
Të dhirtat	250 lekë/krerë/vit;
Derrat	300 lekë/krerë/vit;
Njëthundrakët	600 lekë/krerë/vit;
Njëthundrakët (gomar)	200 lekë/krerë/vit;
Koshere blete	1 lekë/koshere/vit.

5. Tarifat për heqjen e sipërfaqes nga fondi pyjor brenda ZMM-së

Me miratim, sipas dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi

Sipërfaqja me bimësi pyjore	500 lekë/m²;
Sipërfaqja me bimësi kullosore	250 lekë/m²;
Sipërfaqja pa bimësi	100 lekë/m²;
Sipërfaqja ujore	300 lekë/ m².

6. Tarifat për qëllime të ekoturizmit

a) Hyrja e vizitorëve, që nuk janë banorë lokal dhe e mjeteve nëpërmjet pikave të caktuara të aksesit të kontrolluar në parqet e menaxhuar:

Për vizitorët dhe turistët (me këmbë, biçikleta)	50 lekë/ditë/personi;
Mjete të çfarëdolloj me kapacitet deri në 5 persona	150 lekë/ditë/mjeti;
Mjete të çfarëdolloj me kapacitet 6 deri në 10 persona	200 lekë/ditë/mjeti;
Mjete të çfarëdolloji me kapacitet 11 deri në 20 persona	250 lekë/ditë/mjeti;
Mjete të çfarëdolloj me kapacitet 21 deri në 50 persona	300 lekë/ditë/mjeti;
Mjete të çfarëdolloji me kapacitetmbi 51 persona	500 lekë/ditë/mjeti.

b) Përcaktimi i vendeve të aksesit të kontrolluar në parqet e menaxhuara bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës.

c) Kampingje individuale ose kolektive, në çdo formë të ushtruar, lejohet, ekskluzivisht në zonat e dedikuara posaçërisht për këtë qëllim

Çadra kampingu deri në 3 veta	150 lekë/ditë/çadër;
Çadra kampingu mbi 4 veta	300 lekë/ditë/çadër;
Ruleta	500 lekë/ditë;
Baraka druri	1 000 lekë/ditë/barakë.

ç) Filmimi i imazheve të peizazheve, florës dhe faunës së egër apo dhe objekteve të ngjashme të territorit të ZMM-së (përveç rastit të ushtrimit të së drejtës gazetareske) paguhet një tarifë e përcaktuar, si më poshtë:

- xhirimet e planifikuara për kinematë 100 000 lekë për çdo minutë deri në 20 minuta dhe 40 000 lekë për çdo minutë të njëpasnjëshme;
- produktet televizive, multimediale ose videoklipe 80 000 lekë për çdo minutë regjistrimi deri në 10 minuta dhe 40 000 lekë për çdo minutë të mëvonshme;
- prodhimin e spoteve reklamuese 40 000 lekë për çdo sekondë të kohëzgjatjes.

Shënim. Tarifat lidhur me autorizimin për shitjen ndaj palëve të tretan të produkteve të bëra me imazhe të marra në ZMMn janë në vlerë trefish të të drejtave të lartpërmendura.

d) Përdorimi i fotografive të marra nga ZMM-ja, paguhet tarifa si më poshtë:

Përdorimi i fotografive për:

- botime fotografike (me përjashtim të botimeve shkencore)	15 000 lekë për çdo përdorim;
- revista	3 000 lekë për çdo përdorim;
- reklamat	30 000 lekë.
dh) Për veprimtari të ndryshme në natyrë, në çdo rast	100 lekë/ditë/personi;
e) Vëzhgimi i faunës së egër në vendet e posaçme apo dhe në kullat e vrojtimin deri në	700 lekë/ditë/personi;
ë) Zhytjet profesionale në zona të mbrojtura detare dhe liqenore	2 500 lekë/dita/personi i autorizuar;
f) Për aktivitetet e lejuara ekoturistike, çlodhëse, argëtimi dhe sportive të çfarëdolloj karakteri,	1 300 lekë/dita/person;
g) Për aktivitetet artistike të çfarëdolloj karakteri	13 000 lekë/dita/për çdo aktivitet;
gj) Për organizimin e garave në zonat e lejuara, sipas dispozitave ligjore në fuqi:	
- automjete të çfarëdolloj	3 500 lekë/ditë/mjeti;
- motoçikleta të çfarëdolloj	2 000 lekë/ditë/mjeti;
- biçikleta të çfarëdolloj	200 lekë/ditë/mjeti;
- vozitje të çfarëdolloj (det+liqen)	1 300 lekë/ditë/mjeti;
- vozitje me kanoe me 1–3 persona (lumë)	350 lekë/ditë/për çdo kanoe;
- vozitje me kanoe me 4–9 persona (lumë)	700 lekë/ditë/kanoe;
- vozitje me kanoe me mbi 10 persona (lumë)	1 200 lekë/ditë/kanoe;
- deltaplane të çfarëdolloj	1 000 lekë/ditë/mjeti.

h) Për ankorimin e varkave/skafeve dhe të mjeteve të tjera të lundrimit:

- mjete me kapacitet deri në 5 persona dhe të motorave të ujit, 1 300 lekë/ditë/varka;
- ankorimi i varkave/skafeve me kapacitet mbi 5 persona, 2 000 lekë/ditë/varka;
- ankorimi i jahteve dhe i mjeteve të tjera të lundrimit, 13 000 lekë/ditë/mjeti.

i) Për vendosjen e stendave, tabelave, reklamave, shënjave dhe posterave të çdo karakteri, 1 000 lekë/m^2.

7. Tarifat për qëllime të kërkimit shkencor dhe të grumbullimit të materialit gjenetik dhe të mostrave

a) Hulumtuesit, studiuesit dhe specialistët e autorizuar nga AKZM-ja për të kryer kërkime dhe monitorime të karakterit shkencor-studimor, 1 000 lekë/muaj/personi;

b) Gumbullimi i materialeve gjenetike dhe mostrave:

- Për llojet e florës së egër	3 000 lekë/mostra;
- Për llojet e faunës së egër	10 000 lekë/mostra;
- Për minerale etj. të kësaj natyre	33 000 lekë/mostra;
- Për gjetjet paleontologjike	60 000 lekë/mostra;
- Për analizat e tokave	5 000 lekë/mostra.

VENDIM
Nr. 20, datë 20.1.2021

PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të

ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali e ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokolleve të diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që ofron çdo spital, ndahet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore, të ofruara prej tyre.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me këto metoda:

a) Buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i. paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii. kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii. mallra e shërbime të tjera.

b) Buxhetim global për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxhetimi global detajohet për çdo spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon spitalet, në zbatim të vendimit nr. 258, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, 'Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës"'. Fondi rishikon financimin e spitaleve për këtë kontratë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale dhe/ose të strukturës së saj përgjegjëse.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar të buxhetit.

8. Rishpërndarja e buxhetit ndërmjet spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3% të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. Një fond jo më i madh se 32% e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përkatësisht, për:

a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;

b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda e jashtë vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;

d) pagesa të shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas legjislacionit për partneritetin publik privat;

dh) transferta për individët (mjekë specialistë).

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor vlerëson kërkesat e spitaleve (rajonale/bashkiake) për investimet dhe ia paraqet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratim. Spitalet universitare e paraqesin kërkesën për investime në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet tërësisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.

12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese (spitaleve), mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra, shërbime dhe investime.

13. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

14. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale auditon spitalin, nëpërmjet strukturës së saj audituese, për zbatimin e standardeve të miratuara prej saj dhe për raste të tjera me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

15. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor kontrollojnë, monitorojnë buxhetin spitalor, vlerësojnë aktivitetin vjetor të spitaleve dhe treguesit e performancës nëpërmjet strukturave të tyre audituese dhe kontrolluese, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e financimit. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor monitoron dhe vlerëson performancën e punonjësve të spitaleve rajonale e bashkiake, sipas treguesve të kontratës së financimit.

16. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është 12 016 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëmbëdhjetë) veta, nga të cilët 141 (njëqind e dyzet e një) punonjës në Spitalin Universitar të Traumës për Shërbimin e Urgjencës Ambulatore dhe Shërbimin e Ortopedi-Traumatologjisë. Numri dhe struktura e punonjësve për çdo spital miratohen nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

17. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale e bashkiake, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë, sipas nevojave. Këta mjekë të specialiteteve të ndryshme, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Vlera e bonusit përcaktohet, rast pas rasti, nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës "e", të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", të ndryshuar.

18. Mjekët e kontraktuar, sipas pikës 17, të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave "a" e "b", të pikës 9/1, të vendimit nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës", të ndryshuar.

19. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti për shërbimet i spitalit.

20. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

21. Vendimi nr. 42, datë 22.1.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020", të ndryshuar, shfuqizohet.

22. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA NR. 1
LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë:
a) Hemodinamika;
b) Reanimacioni i kardiologjisë.
2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezisë-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencave polivalente;
10. Shërbimi i hipertonisë dhe mjekësisë interne;
11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë (SU "Trauma");
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë maksilo-faciale;
19. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
20. Shërbimi i kirurgjisë digjestive;
21. Shërbimi i urologjisë;
22. Shërbimi i djegie-plastikës;
23. Shërbimi i neurologjisë;
24. Shërbimi neurovaskular (stroke dhe poststroke);
25. Shërbimi i neurokirurgjisë;
26. Shërbimi i onkologjisë;
27. Shërbimi i sëmundjeve infektive;
28. Shërbimi i pediatrisë së specialiteteve;
29. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
30. Shërbimi i pediatrisë infektive;
31. Shërbimi i urgjencës dhe i pediatrisë së përgjithshme;
32. Shërbimi i kirurgjisë infantile;
33. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
34. Shërbimi i laboratorëve (klinikë – biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësore, laboratori i mjekësisë nukleare);
35. Shërbimi i imazherisë dhe i mjekësisë nukleare;
36. Shërbimi i fizioterapisë;
37. Shërbimi i statistikave;
38. Shërbimi i pneumologjisë;
39. Kirurgjia torakale;
40. Shërbimi i ftiziatrisë;
41. Shërbimi i gjinekologjisë;
42. Shërbimi i obstetrikës;
43. Shërbimi i patologjisë së barrës;
44. Shërbimi i neonatologjisë;
45. Shërbimi i farmacisë;
46. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatore;
47. Shërbimi i toksikologjisë klinike;
48. Shërbimi i psikiatrisë (QSUT);
49. Kontrolli i infeksioneve spitalore;
50. Shërbimi i urgjencës ambulatore.

II. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të përgjithshme në nivel qarku ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologjisë, urologjisë, ORL, okulistikës, angiologjisë, max-facial;
4. Shërbimin e obstetrikë-gjinekologjisë;
5. Shërbimin e neonatologjisë;
6. Shërbimin e pediatrisë;
7. Shërbimin e radiologjisë;
8. Shërbimin e fizioterapisë;
9. Shërbimin e anatomisë dhe histologjisë patologjike;
10. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë e të mikrobiologjisë;
11. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;
12. Shërbimin e farmacisë;
13. Shërbimin e onkologjisë (kimioterapisë, kujdesi paljativ);
14. Kontrollin e infeksioneve spitalore;
15. Shërbimin psikosocial;
16. Shërbimin e konsultave të specializuara (poliklinika e specialiteteve);
17. Bankën e gjakut.

III. SPITALET NË NIVEL BASHKIE

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme;

4. Shërbimin e pediatrisë dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;

5. Shërbimin e radiologjisë;

6. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikëe të mikrobiologjisë;

7. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;

8. Shërbimin e farmacisë;

9. Shërbimin ambulator i specializuar;

10. Bankën e gjakut.

Trajtimi i kimioterapisë do të ofrohet nga shtatë spitale: Spitali i Durrësit, Spitali i Vlorës, Spitali i Shkodrës, Spitali i Korçës, Spitali i Lezhës, Spitali i Fierit dhe Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi".

SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

SHTOJCA NR. 2
BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2021

Institucionet	(Buxheti në 000 lek, sipas artikujve)					Totali
	art. 600	art. 601	art. 602	art. 604	Rezervë	
BERAT	275,000	42,900	170,000			487,900
BULQIZË	70,500	11,650	30,000			112,150
DELVINË	33,000	5,350	6,500			44,850
DEVOLL	47,000	7,750	10,000			64,750
DIBËR	239,000	38,470	115,000			392,470
ELBASAN	401,000	64,420	240,000			705,420
FIER	365,500	58,800	242,000			666,300
GRAMSH	114,000	17,670	37,000			168,670
GJIROKASTËR	205,000	32,200	94,000			331,200
HAS	47,500	6,850	13,000			67,350
KAVAJË	104,200	16,900	30,000			151,100
KOLONJË	76,800	12,600	20,000			109,400
KORÇË	424,200	61,900	206,000			692,100
KRUJË	135,000	18,100	26,000			179,100
KUÇOVË	65,500	9,800	15,000			90,300
KUKËS	255,000	38,000	108,000			401,000
KURBIN	83,000	12,900	30,000			125,900
LEZHË	242,000	38,000	122,000			402,000
LIBRAZHD	131,800	21,700	51,000			204,500
LUSHNJË	212,500	33,500	100,000			346,000
MALËSI E MADHE	21,800	3,600	6,000			31,400
MALLAKASTËR	41,800	6,800	13,000			61,600
MAT	117,500	18,900	36,000			172,400
MIRDITË	99,800	15,500	27,000			142,300
PEQIN	33,500	5,550	5,500			44,550
PËRMET	73,200	12,200	35,000			120,400
POGRADEC	154,000	24,500	77,000			255,500
PUKË	92,000	13,900	35,000			140,900
SARANDË	147,000	22,200	100,000			269,200
SKRAPAR	76,700	12,700	16,000			105,400
SHKODËR	514,500	80,900	200,000			795,400
TEPELENË	83,000	13,200	16,000			112,200

QSUT	2,208,700	324,350	3,000,500			5,533,550
SUOGJ "MBRETËRESHA GERALDINË"	277,500	43,900	280,000			601,400
SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	222,700	36,400	216,000			475,100
SU "SHEFQET NDROQI"	562,000	51,700	408,000			1,021,700
SU TRAUMA	151,000	19,500	180,000			350,500
TROPOJË	96,100	15,700	32,000			143,800
VLORË	380,700	61,250	310,000			751,950
Paketat e shërbimeve				3,185,080		3,185,080
Transferta për individët (mjekë specialistë)				30,000		30,000
Trajtime me VKM				30,000		30,000
Pagesat e shërbimeve PPP				3,764,426		3,764,426
Rezervë					468,001	468,001
TOTALI	**8,881,000**	**1,332,210**	**6,658,500**	**7,009,506**	**468,001**	**24,349,217**

SHTOJCA NR. 3
LISTA E INSTITUCIONEVE QË NUK DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Riaftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.

UDHËZIM
Nr. 4 , datë 31.12 2020

MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORËVE TË TURIZMIT DETAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 43, datë 27.4.2020, "Për aktivitetet e turizmit detar",

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e kritereve që duhet të plotësojë operatori turistik për ushtrimin e aktiviteteve të turizmit detar, si dhe procedurës për certifikimin si "Operator i turizmit detar", sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2020, "Për aktivitetet e turizmit detar".

2. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 43, datë 23.4.2020, "Për aktivitetet e turizmit detar", ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Certifikatë", dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, i cili tregon se një subjekt është i certifikuar për të vepruar si operator i turizmit detar.

b) "Komisioni", Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike, i cili funksionon sipas ligjit nr. 93/2015, të ndryshuar dhe të akteve nënligjore përkatëse.

3. Asnjë subjekt nuk mund të veprojë, të ofrojë shërbime si operator i turizmit detar ose të përdorë emërtimin "Operator i turizmit detar" në Republikën e Shqipërisë, nëse nuk është pajisur me certifikatë sipas këtij udhëzimi.

II. KRITERET PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË "OPERATOR I TURIZMIT DETAR"

1. Subjekti, i cili kërkon të pajiset me certifikatën e operatorit të turizmit detar, për çdo aktivitet

turistik detar ose/dhe për të gjitha aktivitetet, përveç respektimit të parashikimeve të ligjit nr. 43/2020, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë i pajisur me licencë XIII.1.B, sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, si operator turistik;

b) të ketë kontratë për vendbazimin e mjeteve lundruese me një port, marinë apo një subjekt që zotëron një stacion sezonal ankorimi në Republikën e Shqipërisë;

c) të ketë një plan menaxhimi të emergjencave, sipas karakteristikave të çdo lloji aktiviteti për zonën ku do të ofrojë shërbimin;

d) të ketë në pronësi apo në përdorim mjete lundrimi turistike në gjendje teknike të përshtatshme për ushtrimin e aktiviteteve të turizmit detar, vërtetuar me certifikatën e pronësisë apo kontratë të lidhur mes palëve të noterizuar;

e) të sigurojë përgjegjësitë ndaj palëve të treta në ujërat e detit të brendshëm dhe detit territorial të Republikës së Shqipërisë;

f) të njohë dhe sigurojë zbatimin e Kodit të Etikës së Operatorit të Turizmit Detar, miratuar me urdhër ministri.

III. DOKUMENTACIONI

1. Kërkesa për pajisjen me certifikatë duhet të përmbajë:

a) të dhënat e përfaqësuesit ligjor (emrin, mbiemrin, numrin personal, adresën e saktë, numrin e telefonit, adresën *email);*

b) të dhënat për subjektin (emrin tregtar, NIPT, numrin e licencës, adresën, numrin e telefonit, adresën *email);*

c) zonën dhe/ose zonat e ushtrimit të aktivitetit, në përputhje me zonat e miratuara nga KKT-ja, sipas nenin 6, pika 2, të ligjit 43/2020;

ç) përshkrimin e aktivitetit/aktiviteteve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 28.10.2020, "Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi";

d) vendin, datën dhe nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor.

2. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) fotokopjen e letërnjoftimit ose pasaportës të përfaqësuesit ligjor;

b) fotokopje të licencës XIII.1.B dhe një kopje të ekstraktit historik të QKR-së;

c) kontratën e vendbazimit lidhur midis subjektit aplikues dhe subjektit që administron vendbazimin;

d) plan menaxhimi të emergjencave të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;

e) dokument që vërteton pronësinë apo kontratën noteriale, lidhur për përdorimin e mjeteve lundruese me qëllimin aktivitetin detar;

f) listë me të dhënat e mjeteve të lundrimit, në funksion të aktiviteteve që do të ofrohen (lloji i mjetit, numri i identifikimit, flamuri, kapaciteti, viti i prodhimit, personi përgjegjës, numri i kontaktit). Për mjetet me flamur të huaj, një kopje të licencës VII.4.1;

g) certifikatën e sigurisë apo të klasës së lëshuar nga shoqëria klasifikuese, sipas legjislacionit në fuqi për mjetet lundruese;

h) policë sigurimi e mjetit lundrues, të përgjegjësisë ndaj palëve të treta;

i) deklaratë të nënshkruar nga subjekti, ku angazhohet të respektojë kriteret e përcaktuara në Kodin e Etikës së Operatorit të Turizmit Detar.

IV. PROCEDURA E APLIKIMIT DHE E SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT

1. Kërkesa me dokumentacionin, sipas kreut 3, pika 2, të këtij udhëzimi, depozitohet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe shqyrtohet nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike.

2. Komisioni, brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës së aplikuesit dhe e paraqitjes së dokumentacionit, sipas pikës 2, të kreut III, nis shqyrtimin e kërkesës.

3. Në qoftë se kërkesa e subjektit për pajisjen me certifikatë nuk është në përputhje me sa parashikohet në pikat 1 deri në 2, të kreut III, ministria përgjegjëse për turizmin, brenda 7 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, njofton aplikuesin, me shkrim ose *email*, për plotësimin e dokumentacionit ose korrigjimin e pasaktësive dhe i cakton atij një afat 7-ditor për paraqitjen e dokumentacionit përkatës.

4. Kur kërkesa e subjektit është në përputhje me sa parashikohet në pikat 1 deri në 2, të kreut III, Komisioni merr një mendim të specializuar nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit për kapacitetet

dhe karakteristikat e zonës së kërkuar për ushtrim aktiviteti detar, brenda 10 ditëve. Për këtë të fundit, AKB-ja mund të bashkëpunojë me institucione të tjera.

5. Në përfundim të procesit të shqyrtimit, Komisioni i Standardizimit merr vendim për lëshimin ose jo të certifikatës "Operator i turizmit detar". Në rast se, kur komisioni refuzon kërkesën për pajisje me certifikatë, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

6. Kundër vendimit të komisionit, i cili refuzon kërkesën për pajisje me certifikatë, mund të paraqitet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

V. LËSHIMI I CERTIFIKATËS "OPERATOR I TURIZMIT DETAR"

1. Brenda 5 ditëve nga data e vendimit të komisionit, subjektit i lëshohet certifikata për të vepruar si operator i turizmit detar.

2. Certifikata, sipas modelit standard, nënshkruhet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e subjektit aplikues dhe numrin e NIPT-it;

b) numrin e licencës së operatorit turistik;

c) adresën e subjektit;

ç) llojin e aktivitetit të turizmit detar të miratuar;

d) zonën e ushtrimit të aktivitetit të turizmit detar;

dh) datën e lëshimit të certifikatës.

3. Për çdo ndryshim të të dhënave të operatorit të turizmit detar, subjekti është i detyruar të informojë ministrinë përgjegjëse për turizmin.

4. Komisioni shqyrton rast pas rasti ndryshimet e të dhënave të operatorit të turizmit detar dhe vlerëson nëse subjekti duhet të kryejë një aplikim të ri.

5. Vlefshmëria e certifikatës së operatorit të turizmit detar është me afat 5-vjeçar, për zonën dhe aktivitetet e miratuara.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi

URDHËR
Nr. 419, datë 14.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË NR. 169, DATË 10.6.2020, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PARAQITJEN DHE TRAJTIMIN E SHPREHJEVE TË INTERESIT, SI DHE VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE PËR ANËTARË TË BORDIT DISIPLINOR"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të nenit 42, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë",

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 169, datë 10.6.2020, "Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"8. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve fillon jo më vonë se 5 ditë nga mbarimi i afatit për dorëzimin e dokumentacionit dhe përfundon jo më vonë se 60 ditë nga data e nisjes.".

2. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

"12. Subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim administrativ pranë ministrit të Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 11 të këtij urdhri.".

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

URDHËR
Nr. 23, datë 18.1.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 434, DATË 22.7.2020, "PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE MJEKËSORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË, TË NIVELIT TË PARË DHE EPROR, PËR VLERËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neni 4, pika 3, dhe nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar; pikave 2 dhe 7 të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal",

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 434, datë 22.7.2020, "Për miratimin e përbërjes së komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, të nivelit të parë dhe epror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara", bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2, germa "b", "Komisioni (KMCAP/KMVP) për sëmundjet e përgjithshme", mbas germës "iii" shtohet germa "iv", "znj. Flutura Beqo (mjek i përgjithshëm)".

2. Në pikën 2, germa "d", "Komisioni (KMCAP/KMVP) për para/tetraplegji", zëvendësohet me "Komisioni (KMCAP/KMVP) për para/tetraplegji dhe neurologji", pika "ii", "z. Drini Dobi zëvendësohet me z. Eris Ranxha (neurolog).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 30, datë 18.1.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 682, DATË 21.12.2020, "PËR NDALIMIN E LËVIZJES PËRMES RRUGËVE AJRORE ME BRITANINË E MADHE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, germa "a", të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, datë 21.12.2020, nr. 5612,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 682, datë 21.12.2020, "Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Britaninë e Madhe", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi "deri në datën 18.1.2021" zëvendësohet me togfjalëshin "deri në datën 1.2.2021".

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 1, datë 11.1.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN DHJETOR 2020

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit",

